

Nr: 03-103/2

Shkup: 05.05.2020

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 05.05.2020, solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës shqyrtoi kërkesën për mendim të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale me nr. 03-103/1, dhe në lidhje me Rregulloren me fuqi ligjore për subvencionimin e pagesës së kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 92/20), në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullore".

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga dhënësi i ndihmës shtetërore paraqet ndihmë shtetërore, vlerësohet nëse katër kriteret e mëposhtme janë plotësuar në mënyrë kumulative:

- Një masë e tillë duhet të përfshijë transferimin e mjeteve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të paraqet përfitim ekonomik për marrësin;
- Të ketë ndikim në konkurrencë dhe tregti

Komisioni vlerësoi se, duke pasur parasysh se subvencionimi në Rregullore përfshin transferimin e mjeteve shtetërore dhe paraqet një përfitim ekonomik për marrësin e ndihmës, dhe i referohet detyruesve të cilët i plotësojnë kushtet e nenit 4 të Rregullores, dhe e njëjta **paraqet ndihmë shtetërore në bazë të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.**

Sipas asaj që u tha më lartë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale **ka për obligim** deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë Njoftim për dhënie të planifikuar të ndihmës në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 142/11), në Formularin e dhënë si Shtojca I e Rregullores së mësipërme.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски